



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. ____ Prot.

Krujë, më 22.04.2026

Shtojca 15.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 22.04.2026

Drejtuar:

1.OE: “BAMI HOLDING” sh.p.k me seli ne Durres, Fushe-Kruje, Kameras dhe me zyre Qendrore me adrese Rruga e Durresit, pallati mbrapa Ring Center, kati 1, Tirane, Albania, 1001’, me nr NIPT-i, J94416206R, me administrator Gezim Marku.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 172’235’914.02**(Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë zero dy)lek pa t.v.sh.

- **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐ JO ☒

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) jo

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Drejtuar:

1. “UDHA” sh.p.k, me adresë Lagjia “Pjeter Budi”, Burrel, 8001, me NIPT K77524909Q dhe me administrator z. Arben Çela.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 161’928’268.14** (Njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katërmëdhjetë) lek pa t.v.sh.

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) jo

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

- Tipi i Kontratës:Kontrate pune
- **Lloji i procedurës:** ‘‘Procedure e Hapur ‘‘
- **Numri i referencës së procedurës /Lotit : REF-67572-11-03-2025.**
- **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:**‘‘Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Fushe-Kruje, Bashkia Kruje’’.
- **Fondi limit/Vlera totale e pritshme e kontratave te lidhura gjate vlefshmerise se Marreveshjes Kuader: 197’903’543** (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh, vene ne dispozicion nga te ardhurat e Bashkise Kruje sipas programeve buxhetore te miratuara me VKB nr.72 date 26.12.2024 ‘‘Per miratimin e buxhetit te vitit 2025’’ i ndryshuar .
- Vlera e likudimit per **vitin ushtrimor 2025** eshte 91’666’210.8(nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dhjetë presje tete) leke pa t.v.sh dhe 109’999’453(njëqind e nëntëmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katerqind e pesëdhjetë e tre) leke me t.v.sh, **per vitin ushtrimor 2026** vlera e likudimit do te jete ne shumen prej 69’413’224.2(gjashtëdhjetë e nëntë milion e katerqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e kater presje dy) leke pa t.v.sh dhe 83’295’869(tetëdhjetë e tre milion e dyqind e nëntëdhjetë e pese mijë e teteqind e gjashtëdhjetë e nëntë) leke me t.v.sh dhe **per vitin ushtrimor 2027** vlera e likudimit do te jete ne shumen prej 36’824’108.3(tridhjetë e gjashtë milion e teteqind e njëzet e kater mijë e njëqind e tete presje tre) leke pa t.v.sh dhe 44’188’930(dyzet e kater milion e njëqind e tetëdhjetë e tete mijë e nëntëqind e tridhjetë) leke me t.v.sh .

- **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** Kontratat do të jepen brenda periudhës **12 (dymbëdhjetë) mujore** nga momenti i lidhjes së Draft-Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të suksesshëm.
- Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit 10.04.2026
- ¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit, [Buletini Nr. 28 datë 20.04. 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. BOE “**Almo Konstruksion**” sh.p.k , me adresë Zall-Mner i ri, rruga nacionale Kamëz, Tiranë, me NIPT J91915001P dhe administrator z.Alfons Bitri, përqindja në pjesëmarrje 73% & “**K.Turja**” sh.p.k me adresë pranë urës së Gjolës, Bubq Fushë-Krujë, me NIPT K81314014A dhe administrator z.Genci Turja dhe me mbështetës “Vashtemia”sh.p.k me NIPT J64103054Q me adresë Korce dhe administrator z.Gezim Avdolli, përqindja në pjesëmarrje 27%.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 177’248’275** (Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lek pa t.v.sh.
2. “**Bami Holding**”sh.p.k , me adresë Fushë-Krujë Kameras dhe me zyrë qendrore Pallati mbrapa Ring Center, Kati I Tiranë 1001, me NIOPT J94416206R, me administrator z.Gëzim Marku.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 172’235’914.02**(Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë zero dy)lek pa t.v.sh.
3. BOE “**BE-IS**” sh.p.k , me adresë Rr. Qemal Stafa, Pll.66, H. 3, Ap. 24, Tirane 1001, me NIPT K71412003A , me administrator z. Z. Mustaf Islamaj, përqindja në pjesëmarrje 60% & “**Ergi**” sh.p.k , me adresë Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurisë 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan dhe Kukes Kalis Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes, me NIPT K02727229P, me administrator z.Ergi Balla, përqindja në pjesëmarrje 40% .
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 155’445’660** (Njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e katërqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lek pa t.v.sh.

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

4. **“Curri” sh.p.k**, me adresë Rr. "Kajo Karafili", Nd.2, H.4, Ap.3, 1001, Tiranë, me NIPT J67902718S dhe administrator z. Fjoralb Curri.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 155’670’050.13**(Njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëdhjetë pikë trembëdhjetë) lek pa t.v.sh.

5. **BOE “Kegli-Duri”sh.p.k** , me adresë Fushe-Kruje lagja e grumbullimit, rruga e vjeter e Laçit, pallati i ri, kati i pare, zona zadasrtael 1664, me nr.pasurie 34/26, kodi postar 1502, me NIPT K94016202U dhe me administrator z.Durim Babasi, përqindja në pjesëmarrje 26.59 % & **“Varaku-E” sh.p.k**, me adresë Durres Shijak Qarku Durres, Bashkia Shijak,Njesia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, ZonaKadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, me NIPT J61902509S dhe administrator z. Shpetim Varaku, përqindja në pjesëmarrje 26.37% & **“L.T.E Construction” sh.p.k** , me adresë Tirane KASHAR, Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1, me NIPT L78006801F dhe administrator z. Artur Caushaj, përqindja në pjesëmarrje 47.04%.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 165’895’056.86** (Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lek pa t.v.sh.

6. **BOE “Lis Konstruksion” sh.p.k** , me adresë Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë, me NIPT K66613407H, me administrator znj.Doriana Murati, përqindja në pjesëmarrje 54.4% & **“Viante Konstruksion” sh.p.k** me adresë, lagjia sporti, Gramsh, me NIPT K47103804L dhe administrator z.Gjergj Bezati, përqindja në pjesëmarrje 45.6%.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 160’767’592.85** (Njëqind e gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e pesë) lek pa t.v.sh.

7. **BOE “Makaresh” sh.p.k**, me adresë Fushe-Kruje lagja e grumbullimit, rruga e vjeter e Laçit, pallati i ri, kati i pare, zona zadasrtael 1664, me nr.pasurie 3/426, kodi postar 1502, me NIPT K24725213C dhe administrator z.Qamil Babasi, përqindja në pjesëmarrje 8.58% & **“B 93 II” sh.p.k** , me adresë Rruga "Margarita Tutulani", Pallati Kaso , Kati 7-t, Ap.76, Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë, me NIPT L52209050O, me administrator z. Ardit Liçaj, përqindja në pjesëmarrje 55.78% & **“Beqiri” sh.p.k**, me adresë Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta,pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte, me NIPT J98624801V dhe me administrator z.Neim Beqiraj, përqindja në pjesëmarrje 35.64%.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 161’286’212** (Njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lek pa t.v.sh.

8. **“Ndregjoni”sh.p.k**, me adresë Tirane , Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega , ndertesa nr. 32, hyrja 8 kodi postar 1017, me NIPT K31329048I dhe me administrator z.Xhetan Ndregjoni, me mbështetje “Asi 2A CO”sh.p.k me NIPT K53002402C me adresë Fier dhe administrator z.Astrit Gjikondaj dhe “Asi Invest”sh.p.k me NIPT M4927023N me adresë Tiranë dhe administrator z.Shkelqim Dezhgiu.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 164’688’981.59** (Njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lek pa t.v.sh.

9. **“Pepa Group” sh.p.k**, me adresë Autostrada Tirane- Durres km 6, rruga dytesore “Iliria”, Kashar , Tirane (AL), Kodi Postar 1029 , me NIPT L42215009L dhe me administrator z.Lulezim Pepa.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 162’033’632.72** (Njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e dy) lek pa t.v.sh.

10. **BOE “RSM Company” sh.p.k** (“R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqërisë me emër RSM COMPANY), me adresë Tirane 1001, me NIPT L04803001U dhe administrator znj.Elida Kola, përqindja në pjesëmarrje 30.31% & **“Biba-x” sh.p.k** , me adresë Tirane Lekaj HARIZAJ Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m prane Karburant “EURODRIN” Kodi postar 2507, me NIPT K32618815N dhe me administrator z.Skender Biba, përqindja në pjesëmarrje 69.69%.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 128’458’606** (Njëqind e njëzet e tetë milion e katërqind e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lek pa t.v.sh.

11. **“Shendelli” sh.p.k**, me adresë Lagjia "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier 9301, me NIPT K07924803N dhe me administrator z.Yzedin Bozhaj.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 149’380’147** (Njëqind e dyzet e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lek pa t.v.sh.

12. **“Shpresa-Al” sh.p.k**, me adresë Rruga “Urani Pano”, pas Qendres VEVE, PALL. 11 katesh, kati 2, zyra nr.1-TIRANE- Kodi postar-1001, me NIPT K31321021N dhe me administrator z.Dritan Osmani.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 146’565’622.63** (Njëqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e tre) lek pa t.v.sh.

13. **“Udha” sh.p.k**, me adresë Lagjia “Pjeter Budi”, Burrel, 8001, me NIPT K77524909Q dhe me administrator z. Arben Çela.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 161’928’268.14** (Njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katërmëdhjetë) lek pa t.v.sh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Ne fazën e vlerësimit paraprak (referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE) , janë skualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë vijon:

1. **BOE “RSM Company” sh.p.k** (“R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqërisë me emër RSM COMPANY), me adresë Tirane 1001, me NIPT L04803001U dhe administrator znj.Elida Kola, përqindja në pjesëmarrje 30.31% & **“BIBA-X” sh.p.k** , me adresë Tirane Lekaj HARIZAJ Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50 m prane Karburant “EURODRIN” Kodi postar 2507, me NIPT K32618815N dhe me administrator z.Skender Biba, përqindja në pjesëmarrje 69.69%.
 - **Vlera e ofertës ekonomike: 128’458’606** (Njëqind e njëzet e tetë milion e katërqind e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

BOE “RSM CONSTRUCTION” d.sh.h & “BIBA-X”sh.p.k nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

1-a-Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin e kontratave:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, në shumë prej 98’951’771 (nëntëdhjetë e tete milion e nentëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) leke pa t.v.sh dhe që është realizuar gjatë 5(pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b)punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5(pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , është jo më e vogël se vlera e dyfishit të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, 395’807’086(treqind e nëntëdhjetë e pesëmilion e teteqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa t.v.sh

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme

c)Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

d)Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i-Per punimet e kryera në sektorin publik duhet të paraqiten dokumentacioni provues si vijon:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 09, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përfundimtare.
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

ii-Ndërsa në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratat e sipërmarrjes
- Situacionin përfundimtar
- Akt kolaudimit
- Çertifikatën e marrjes në dorezim / Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Faturat tatimore të shitjes

Konkretisht “RSM CONSTRUCTION” d.sh.h , për kontratën e ngjashme të paraqitur me

objekt: “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaive vazhdimi pjesa e dytë me nr.identifikues 635-22-11435-5-1-1 datë 20.07.2023, ka deklaruar se:

Në Republikën e Kosovës, Autoriteti Kontraktor nuk lëshon Akt Kolaudimi për objektin dhe as certifikatën e marrjes në dorezim të punimeve por për Aktin e Kolaudimit dhe Certifikatën e marrjes në dorezim të punimeve, Autoritetet Kontraktore në Republikën e Kosovës lëshojnë dokumentin : Raport Përfundimtar ku është përcaktuar dhe vlerësimi.

Në Republikën e Kosovës, Autoriti Kontraktor në Procesverbalin e Pranimit Teknik për punët e kryera përcakton vlerësimin dhe nuk lëshon Formularin e Vlerësimit.

Situacioni përfundimtar sipas legjislacionit të Kosovës përfshin Faturë + Certifikatën e Zhvillimit Financiar të kontrates + Paramasa dhe Paralogaria. Në cdo vit pune lëshohet një situacion përfundimtar që përfshin dokumentat e mësipërme.

Në Republikën e Kosovës, në fazën e tenderimit nuk kërkohet prokurë e posacme, por vetem Akt-Marreshja e bashkepunimit të Operatoreve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar ne SPE, rezulton qe Raport Përfundimtar ku eshte percaktuar dhe vleresimi, i deklaruar nga RSM Company , mungon. Sipas deklarates nga RSM Company, Raport Përfundimtar ku eshte percaktuar dhe vleresimi eshte ekuivalent me Akt Kolaudimin dhe Certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve. Mos plotesimi i pikes 2.3.1 (d) i i DST e bën ofertën të pakualifikueshme. Gjithashtu, “RSM Construction” ka paraqitur kontraten me objekt : “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal llot I” me nr.616-22-2845-2-1-1 datë 25.07.2022, ku nga analizimi i situacionit rezulton qe kontrata pëmban vetem punime sinjalistike (NS-6), per kete arsye përvoja e paraqitur nuk ploteson kriteret per pune te ngjashme.

Dokumentacioni i paraqitur nga BOE “RSM CONSTRUCTION” d.sh.h & “BIBA-X”sh.p.k nuk përmbush kushtet për kualifikim.

2. BOE “**Makresh**” sh.p.k, me adresë Fushe-Kruje lagja e grumbullimit, rruga e vjeter e Laçit, pallati i ri, kati i pare, zona zadasrtael 1664, me nr.pasurie 3/426, kodi postar 1502, me NIPT K24725213C dhe administrator z.Qamil Babasi, përqindja në pjesëmarrje 8.58% & “**B 93 II**” sh.p.k , me adresë Rruga "Margarita Tutulani", Pallati Kaso , Kati 7-t, Ap.76, Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë, me NIPT L52209050O, me administrator z. Ardit Liçaj, përqindja në pjesëmarrje 55.78% & “**Beqiri**” sh.p.k, me adresë Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta,pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte, me NIPT J98624801V dhe me administrator z.Neim Beqiraj, përqindja në pjesëmarrje 35.64%.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 161’286’212** (Njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lek pa t.v.sh. (Memoria elektronike e dokumentave të ngarkuara është 446 MB)

BOE “MAKARESH” sh.p.k& “B93 II” sh.p.k& “BEQIRI”sh.p.k, nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta te kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

1-a-Operatoret ekonomik per te provuar pervojen e meparshme te sukseshme duhet te paraqesin te dhenat provuese si me poshte ne ekzekutimin e kontratave:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më te vogel se 50 % e vlerës së përlllogaritur te fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht,ne shume prej 98’951’771 (nentedhjetë e tete milion e nenteqind e pesedhjetë e nje mije e shtatedhjetë e nje) leke pa t.v.sh dhe që është realizuar gjatë 5(pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b)punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5(pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e dyfishit të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, 395'807'086(treqind e nentëdhjetë e pesë milion e tetëqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa t.v.sh.

c)Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b “ duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Konkretisht, për BOE “MAKARESH” sh.p.k& “B93 II”sh.p.k& “BEQIRI”sh.p.k, operatori ekonomik “B93II” sh.p.k dhe operatori ekonomik “Makaresh” sh.p.k nuk plotësojnë vlerën monetare totale për punët e ngjashme të kryera në bazë të përqindjes së tyre në BOE, sipas pikes 2.3.1/b.

Dokumentacioni i paraqitur nga BOE “MAKARESH” sh.p.k & “B93 II” sh.p.k & “BEQIRI” sh.p.k , nuk përmbush kushtet për kualifikim.

BOE: “KEGLI-DURI” sh.p.k , me adresë Fushe-Kruje lagja e grumbullimit, rruga e vjeter e Laçit, pallati i ri, kati i parë, zona zadasrtael 1664, me nr.pasurie 34/26, kodi postar 1502, me NIPT K94016202U dhe me administrator z.Durim Babasi, përqindja në pjesëmarrje 26.59 % & **“VARAKU-E” sh.p.k**, me adresë Durres Shijak Qarku Durres, Bashkia Shijak,Njesia Administrative Shijak Fshati Sallmone, Godinë private, ZonaKadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30, me NIPT J61902509S dhe administrator z. Shpetim Varaku, përqindja në pjesëmarrje 26.37% & **“L.T.E Construction” sh.p.k** , me adresë Tirane KASHAR, Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1, me NIPT L78006801F dhe administrator z. Artur Caushaj, përqindja në pjesëmarrje 47.04%.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 165'895'056.86** (Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lek pa t.v.sh.
(Memoria elektronike e dokumentave të ngarkuara është 643 MB)

BOE “KEGLI-DURI”sh.p.k& “VARAKU-E” sh.p.k & “L.T.E”sh.p.k, nuk ploteson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

1-a-Operatorët ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme të sukseshme duhet të paraqesin të dhënat provuese si më poshtë në ekzekutimin e kontratave:

a)punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht,në shumë prej 98'951'771 (nëntëdhjetë e tetë milion e nentëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) leke pa t.v.sh dhe që është realizuar gjatë 5(pese) viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5(pese) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e dyfishit të fondit limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht, 395'807'086(treqind e nentëdhjetë e pesë milion e teteqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa t.v.sh.

Shenim- Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e bën oferten të kualifikueshme
c) Pika “2.3.1/a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika “2.3.1/b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Konkretisht, për BOE “KEGLI-DURI” sh.p.k & “VARAKU-E” sh.p.k & “L.T.E” sh.p.k Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” sh.p.k nuk plotëson vlerën monetare totale për punët e ngjashme të kryera në bazë të përqindjes së tij në BOE, sipas pikes 2.3.1/b. Dokumentacioni i paraqitur nga BOE “KEGLI-DURI” sh.p.k & “VARAKU-E” sh.p.k & “L.T.E” sh.p.k, nuk përmbush kushtet për kualifikim.

- **Ne fazën e verifikimit të dokumentacionit provues të ofertës (verifikimit të vlerësimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar pranë AK nga ana e operatorëve ekonomik sipas kërkesës së KVO), janë skualifikuar këto operatorë ekonomike.**

3. **“SHENDELLI” sh.p.k**, me adresë Lagjja “Kastrioti”, rruga “Andon Profka”, 2 kullat Fier 9301, me NIPT K07924803N dhe me administrator Z. Yzedin Bozhaj.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 149'380'147** (Njëqind e dyzet e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik **“Shendelli” sh.p.k**, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se :

Dokumentacioni i dorëzuar, përfshirë “Formularin e ofertës ekonomike” sipas shtojcës 1, “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit” sipas shtojcës 2 dhe “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” sipas shtojcës 8 të DST-së dhe deklaratat e paraqitura, nuk i referohen objektit të kësaj procedure prokurimi “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Fushë-Krujë, bashkia Krujë” REF-67572-11-03-2025, por një procedure tjetër “Sistemim asfaltim i rrugëve në territorin e njësisë administrative Bubq”.

Për pasojë, dokumentacioni i dorëzuar nuk përputhet me kërkesat e vlefshmërisë sipas kritereve të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, për procedurën e prokurimi me objekt “Sistemim-Asfaltim i rrugëve në Territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë” dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për vlerësim.

Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur për një procedurë tjetër prokurimi është në kundërshtim me kërkesat thelbësore të Dokumentave Standarde të Tenderit dhe përbën shkak për skualifikimin e operatori ekonomik “Shendelli”sh.p.k.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacione vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4. **“NDREGJONI” sh.p.k.**, me adresë Tirane , Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega , ndertesa nr. 32, hyrja 8 kodi postar 1017, me NIPT K31329048I dhe me administrator z.Xhetan

Ndregjoni, me mbështetje “Asi 2A CO”sh.p.k me NIPT K53002402C me adresë Fier dhe administrator z.Astrit Gjikonaj dhe “Asi Invest”sh.p.k me NIPT M4927023N me adresë Tiranë dhe administrator z.Shkelqim Dezhgiu.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 164’688’981.59** (Njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e nëntë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik **“Ndregjoni” sh.p.k.**, me subjekt mbështetës **“Asi-2A Co”sh.p.k** dhe **“Asi Invest” sh.p.k.**, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se :

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a)** të Dokumentave Standarde të Tenderit- *Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a)* Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinierive të rënda specififikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtuese→**1 manovrator**
- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator grejderi→**1 manovrator**
- Manovrator rruli vibrues →**2 manovrator,**
- Manovrator rruli asfalti →**1 manovrator,**
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrator,**
- Manovrator Autovinçi→**1 manovrator**

Për çdo profil punonjësi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specififikisht manovratorët si më poshtë:

- **1(një)** manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)
- **6(gjashtë)**manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtuese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)

- **1(një)** manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrator Autovinçi)

Operatori ekonomik “Ndregjoni”sh.p.k ka paraqitur kontrata pune për **2(dy) manovratorë/Buldozierist** me subjekt i cili nuk është deklaruar si operator mbështetës ose bashkim operatorësh ekonomik, konkretisht **2(dy)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** rezultojnë të jenë të punësuar me kontratë pranë shoqërisë “Cobial”sh.p.k. Kontrata noteriale e deklaruar për këto **2(dy)** manovratorë/Buldozierist me nr.rep 5216 datë 09.04.2025 mes “Ndregjoni”sh.p.k dhe “Cobial”sh.p.k është vetëm për vënien në dispozicion të mjeteve të punës dhe jo manovratorëve.

Për rrjedhojë, marrëdhënia e punës ndërmjet 2 (dy) manovratorëve me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist (z.Ramadan Shehu dhe z.Lefter Dedgjoni) dhe subjektit “Cobial”sh.p.k nuk krijon marrëdhënie kontraktore të drejtpërdrejt apo të tërthortë ligjërish të vlefshme ndërmjet tyre dhe operatorit ekonomik “Ndregjoni”sh.p.k.

Në mungesë të **2(dy)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**, kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7-** të Dokumentave Standarde të Tenderit-, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës (a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).* Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

Për mjetin **Grejder** konstatohet se është paraqitur vetëm faturë datë 24.03.2016 dhe nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm (çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, polica e sigurimit), pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit. Në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit 2.3.7(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me pikën **2.3-6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik, me pikën 2.3.7 (a) Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës** dhe përbën shkak për skualifikim e operatorit ekonomik “Ndregjoni”sh.p.k.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

5. BOE “**ALMO KONSTRUKSION**” sh.p.k , me adresë Zall-Mner i ri, rruga nacionale Kamëz, Tiranë, me NIPT J91915001P dhe administrator z.Alfons Bitri & “**K.TURJA**” sh.p.k me adresë pranë urës së Gjolës, Bubq Fushë-Krujë, me NIPT K81314014A dhe administrator z.Genci Turja dhe me mbështetës “Vashtemia”sh.p.k me NIPT J64103054Q me adresë Korce dhe administrator z.Gezim Avdolli.

➤ **Vlera e ofertës ekonomike: 177’248’275** (Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyt si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga bashkimi operatorëve ekonomik “Almo Konstruksion” sh.p.k dhe “K.Turja”sh.p.k dhe me subjekt mbështetës “Vashtemia” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7 (a)** të Dokumentave Standarde të Tenderit, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës *(a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme),*

Për mjetin **Grejder** me faturë zhdoganimi datë 08.08.2001 paraqitur nga “Almo Konstruksion”sh.p.k, dhe **Grejder** me faturë zhdoganimi datë 26.08.2015 paraqitur nga “K.Turja”sh.p.k me kontratë qiraje nr. Rep.7695 datë 22.08.2025, nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm (çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, polica e sigurimit), pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit.. Në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit 2.3.7(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a)** të Dokumentave Standarde të Tenderit- *Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:*

- Manovrator asfaltoshtuese → **1 manovrator**
- Manovrator eskavatori → **1 manovrator**
- Manovrator grejderi → **1 manovrator**
- Manovrator rruli vibrues → **2 manovrator,**
- Manovrator rruli asfalti → **1 manovrator,**
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti → **1 manovrator,**
- Manovrator Autovinçi → **1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:

- **1**(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)
- **6**(gjashtë)manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtuese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)
- **1**(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrator Autovinçi)

B.O.E “Almo Konstruksion” sh.p.k dhe “K.Turja”sh.p.k dhe me mbështetës “Vashtemia”sh.p.k, ka paraqitur dokumentacionin provues për **punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmime të aftësisë profesionale si më poshtë:

- 7(shtatë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**
- 4(katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- 4(katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**

Për rrjedhojë, mungojnë **2 (dy)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** nga **6(gjashtë)** të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me kërkesat e DST pika 2.3.7(a) *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe* **2.3.6(a)Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik** dhe përbën kusht për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “Almo Konstruksion”sh.p.k dhe “K.Turja”sh.p.k.

Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. **“Shpresa-Al”sh.p.k**, me adresë Rruga “Urani Pano”, pas Qendres VEVE, PALL. 11 katesh, kati 2, zyra nr.1-TIRANE- Kodi postar-1001, me NIPT K31321021N dhe me administrator z.Dritan Osmani.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 146’565’622.63**(Njëqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e tre) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Shpresa-al” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit**, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme),*

Për mjetin **Grejder** konstatohet se është paraqitur vetëm faturë zhdoganimi datë 19.10.2008 nga dhe nuk disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor i nevojshëm (çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, polica e sigurimit), pasi Grejder është mjet i cili duhet të ketë dokumentacionin ligjor të qarkullimit.Në mungesë të dokumentacionit për mjetin Grejder, kërkesa e kriterit 2.3.7(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a) të Dokumentave Standarde të Tenderit-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik** a)Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrador asfaltoshtruese→**1 manovrador**
- Manovrador eskavatori→**1 manovrador**
- Manovrador grejderi→**1 manovrador**
- Manovrador rruli vibrues →**2 manovrador**,
- Manovrador rruli asfalti →**1 manovrador**,
- Manovrador makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrador**,
- Manovrador Autovinçi→**1 manovrador**

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specifikisht manovradorët si më poshtë:

- **1**(një) manovrador me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist** (Manovrador eskavatori)
- **6**(gjashtë)manovradorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrador asfaltoshtruese; 1 Manovrador grejderi; 2 Manovrador rruli vibrues;1 Manovrador rruli asfalti; 1 Manovrador makinerie skarifikimi asfalti)
- **1**(një) manovrador me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrador Autovinçi)

Operatori ekonomik “Shpresa-Al” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për **punonjës manovradorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmitë të aftësive profesionale si më poshtë:

- **4**(katër) manovradorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**
- **1**(një) manovradorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- **4**(katër) manovradorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**

Për rrjedhojë, mungojnë **5** (pesë) manovradorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** nga **6**(gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me kërkesat e DST pika 2.3.7(a)Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatori ekonomik “Shpresa-al” sh.p.k.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6. “CURRI” sh.p.k, me adresë Rr. "Kajo Karafili", Nd.2, H.4, Ap.3, 1001, Tiranë, me NIPT J67902718S dhe administrator z. Fjoralb Curri.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 155’670’050.13**(Njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëdhjetë pikë trembëdhjetë) lek pa t.v.sh.
-

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Në vijim të kërkesës për paraqitjen e dokumentacionit provues, rezulton se :

Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion provues për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Për rrjedhojë, mungon objekti i shqyrtimit dhe i verifikimit të përmbushjes së kriterëve të kualifikimit dhe operatori ekonomik “Curri”sh.p.k skualifikohet.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. **“PEPA GROUP” sh.p.k**, me adresë Autostrada Tirane- Durrës km 6, rruga dytesore “Iliria”, Kashar , Tirane (AL), Kodi Postar 1029 , me NIPT L42215009L dhe me administrator z.Lulezim Pepa.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 162’033’632.72** (Njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e dy) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Pepa Group” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit**, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, operatori ekonomik ka deklaruar Rrull ngjeshës me deklaratë zhdoganimi datë 13.01.2017 dhe ka paraqitur dokumentacion provues për faturë tatimore shitje tjetër me datë 23.01.2015, duke mos provuar në mënyrë të qartë disponueshmërinë e mjetit të deklaruar.

Për rrjedhojë, mospërputhja ndërmjet vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur nuk provon disponueshmërinë e mjetit të deklaruar dhe kriteri sipas kërkesës 2.3.7 nuk konsiderohet i përmbushur.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a) të Dokumentave Standarde të Tenderit- Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a)**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerve të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtuese→**1 manovrator**
- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator grejderi→**1 manovrator**
- Manovrator rrulli vibrues →**2 manovrator**,
- Manovrator rrulli asfalti →**1 manovrator**,
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrator**,
- Manovrator Autovinçi→**1 manovrator**

Për çdo profil punonjësi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:

- **1**(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)
- **6**(gjashtë)manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtuese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)
- **1**(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrator Autovinçi)

Operatori ekonomik “Pepa-Group” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për **punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmive të aftësisë profesionale si më poshtë:

- **3**(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**
- **2**(dy) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- **3**(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**

Për rrjedhojë, mungojnë **4** (katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** nga **6**(gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

*Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me kërkesat e DST pika **2.3.7** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe **2.3.6(a)** Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pepa Group”sh.p.k.*

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

8. BOE “BE-IS” sh.p.k , me adresë Rr. Qemal Stafa, Pll.66, H. 3, Ap. 24, Tirane 1001, me NIPT K71412003A , me administrator z. Z. Mustaf Islamaj & **“Ergi” sh.p.k** , me adresë Autostrada Elbasan-Metalurgji km.3, numri i pasurise 328/6-NDI, zona kadastrale nr.8526, lagjja 28 Nentori, Rajoni nr.3, Elbasan dhe Kukes Kalis Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes, me NIPT K02727229P, me administrator z.Ergi Balla.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 155’445’660** (Njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e katërqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Be-is” sh.p.k dhe “Ergi”sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se:

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7 (b) të Dokumentave Standarde të Tenderit**, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, (b) *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme),*

Për mjetin autobitumatriçe me targë **AA782FA**, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, mungon certifikata për transport mallrash të rrezikshëm. Referuar lejes së qarkullimit kapaciteti

transportues i mjetit është mbi 1.5 ton dhe sipas pasaportës së verifikimit të botit me nr.serial 000612, vëllimi i tij është 3500 litra dhe duhet detyrimisht të pajiset me çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm.

Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit 2.3.7(b) nuk konsiderohet e plotësuar.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3.7 (c) të Dokumentave Standarde të Tenderit**, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, *që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, (c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj,*

Operatori ekonomik “Ergi”sh.p.k, për mjetete e marra me qira, ka paraqitur kontratë individuale qiraje me nr.52 datë 19.11.2025 mes “Ergi” sh.p.k dhe “Artyka”sh.p.k dhe jo kontrate noteriale në kundërshtim me pikën 2.3.7 (c).

Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit, për mjeti autobitumatriçe nuk konsiderohet kusht i plotësuar nga bashkimi i operatorëve.

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a) të Dokumentave Standarde të Tenderit- Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a)**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtuese→**1 manovrator**
- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator grejderi→**1 manovrator**
- Manovrator rruli vibrues →**2 manovrator,**
- Manovrator rruli asfalti →**1 manovrator,**
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrator,**
- Manovrator Autovinçi→**1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:

- **1(një)** manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)
- **6(gjashtë)**manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtuese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)
- **1(një)** manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrator Autovinçi)

Bashkimi operatorëve ekonomik “Be-is”sh.p.k & “Ergi”sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për **punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmive të aftësisë profesionale si më poshtë:

- **4(katër)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**
- **3(tre)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- **8(tetë)** manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**

Për rrjedhojë, mungojnë **3** (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** nga **6**(gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Be-is” sh.p.k & “Ergi” sh.p.k është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, *që nevojiten për ekzekutimin e kontratës pika* (b),(c) dhe pikën 2.3-6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikim.

Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

9. BOE “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k , me adresë Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqizë, me NIPT K66613407H, me administrator znj.Doriana Murati & “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k me adresë, lagjia sporti, Gramsh, me NIPT K47103804L dhe administrator z.Gjergj Bezati.

- **Vlera e ofertës ekonomike: 160’767’592.85** (Njëqind e gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e pesë) lek pa t.v.sh.

Përkatësisht për arsyet si vijon :

Referuar dokumentacionit në bazë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Lis Konstruksion” sh.p.k dhe “Viante” sh.p.k, si dhe të dhënave të dokumentacionit provues të paraqitur, rezulton se :

Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën **2.3-6(a)** të Dokumentave Standarde të Tenderit- *Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a)* Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerve të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtuese→**1 manovrator**
- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator grejderi→**1 manovrator**
- Manovrator rruli vibrues →**2 manovrator**,
- Manovrator rruli asfalti →**1 manovrator**,
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrator**,
- Manovrator Autovinçi→**1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmite e aftësive profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të **urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.**

Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika **2.3-6 (a)**, kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:

- **1(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist** (Manovrator eskavatori)

- 6(gjashtë)manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**(1 Manovrator asfaltoshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)
- 1(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**(Manovrator Autovinçi)

Bashkimi operatorëve ekonomik “Lis Konstruksion”sh.p.k dhe “Viante” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për **punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmime të aftësisë profesionale si më poshtë:

- 9(nëntë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Automakinist**
- 3(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist**
- 9(nëntë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Eskavatorist**

Për rrjedhojë, mungojnë **3** (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për **Buldozierist** nga 6(gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar.

Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur nga B.O.E “Lis Konstruksion” sh.p.k & “Viante Konstruksion” sh.p.k është në kundërshtim me kërkesat e DST pika 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikim.

Bashkimi i operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme(referuar edhe rivleresimit te kryer ne zbatim te vendimit nr.443/2026 te KPP), informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

- ❖ **“BAMI HOLDING” sh.p.k** me seli ne Durrës, Fushe-Kruje, Kameras dhe me zyre Qendrore me adrese Rruga e Durrësit, pallati mbrapa Ring Center, kati 1, Tirane, Albania, 1001’ , me nr NIPT-i, J94416206R, me administrator Gezim Marku.
 - ❖ Vlera e ofertës=**172’235’914.02**(Njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë zero dy)lek pa t.v.sh.
- ❖ **“UDHA” sh.p.k**, me adresë Lagjia “Pjeter Budi”, Burrel, 8001, me NIPT K77524909Q dhe me administrator z. Arben Çela.
 - Vlera e ofertës ekonomike: 161’928’268.14 (Njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë katërmëdhjetë) lek pa t.v.sh.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [BASHKIA KRUJE QENDER SHESHI MUSTAFA MERLIKA(KRUJA) , Kati i II-te Zyra e Protokollit] brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO ☐

Nëse Po (*Nr. 443/2026 Datë 30.03.2026 i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe vendimi Nr 477/2026 Datë 07.04.2026 heqje pezullimi*).

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Artur BUSHI

Konceptoi:G.Halili

Nr ekzemplareve:3k
Date:_____.2026